

Shenjtori i ditës



E premte, 27 mars 2020 - Shenjtori i ditës.
JEMI NË KRESHMËN E MADHE TË PASHKËS

Dëshmore Matrona. Dëshmor Fileti dhe familja. Roberti, ndriçues i Bavarisë, Austrisë.

- Dëshmore Matrona -

Shën Matrona ishte shërbëtorja e një gruaje fisnike hebreje me emrin Pautila, e cila ishte martuar me një gjeneral të garnizonit perandorak të Selanikut. E adhuronte Jisu Krishtin si Perëndi të vërtetë dhe i lutej në fshehtësi, për të mos tërhequr vëmendjen e zonjës së saj. Kur ajo shkonte përditë në sinagogë, Matrona e shoqëronte deri te porta, pastaj fshihej, që të shkonte menjëherë në kishë për t'u lutur, dhe kthehej kur duhej të dilte Pautila.

Por kur erdhi dita e Pashkës së judenjve, Matriona, e cila dëshironte të merrte pjesë në shërbesat e Ngjalljes së Zotit, Pashkës së vërtetë, e cila na kaloi nga vdekja në jetë, shkoi në kishë, por vonoi të kthehej në sinagogë dhe një nga shërbëtoret e denoncoi. Pautila u zemërua së tepërmi dhe i tha se nëse Matriona e kishte gënjyer në këtë pikë, patjetër që edhe shërbimi i saj do të ishte keqbërës, ndaj u dha urdhër shërbëtorëve që ta lidhnin te një fron dhe ta godisnin me shkopinj.

Akuzave të Pautilas, Matriona iu përgjigj me këto fjalë: “Po, jam e krishterë, por gjithnjë u jam bindur urdhrave të tu, përveçse për çështje besimi. Çfarë i ka munguar shërbimit tuaj që po ma katandisni kështu trupin? Nëse doni të më vdisni, sepse adhuroj Jisu Krishtin, e keni pushtetin mbi jetën time, por s’keni fuqi mbi shpirtin tim, i cili i përket të vetmit Perëndi. Nuk i frikësohem asnjë vuajtjeje; sepse Jisui, Shpëtimtari dhe Mësuesi im, më ndihmon!”

Për tri ditë e mbyllën në qeli dhe kur e hapën, Pautila u çudit, pasi nuk i gjeti asnjë gjurmë plage. Qëndronte më këmbë, nuk ishte e fashuar, fytyra i shkëlqente dhe këndonte lavdërime për Perëndinë. Urrejtja e zonjës u ndez edhe më shumë dhe urdhëroi që këtë radhë ta fshikullonin më fort. Tri herë u përsërit shërimi i plagëve të saj në mënyrë të mrekullueshme, por në fund Matriona, duke dhënë shpirt, tha: “O Zoti Jisu, Shpëtimtar i panjollë që për Ty po vuaj këto tortura, tani po e jap shpirtin tim në duart e Tua, denjo të më presësh në shoqërinë e martirëve të Tu!”.

Që të mos e akuzonin për vrasje, Pautila ia hodhi trupin nga maja e një shkëmbi, që të tjerët të besonin se kishte qenë viktimë e një aksidenti. Më pas episkopi Aleksandër (fillimi i shek. 4), e solli lipsanin e saj të çmuar brenda në qytet, pikërisht në vendin ku u ndërtua kisha kushtuar shën Matronës.

* * * * *

- Dëshmor Fileti dhe familja -

Martiri i shenjtë Fileti dhe familja e tij jetonin me përkushtim, nën sundimin e Adrianit (117-138). U arrestuan dhe u nxorën para perandorit, i cili si nuk mundi t’u përgjigjej fjalëve që Shpirti i Shenjtë i frymëzonte Filetit, e dërgoi te komandanti ushtarak i Ilirikut, Amfiloku. Ky urdhëroi që shenjtorët t’i vinin mbi këmbalec dhe t’i godisnin me shpata druri. Duke parë durimin e tyre mbinjerëzor, sekretari i gjyqit, Kronida, besoi te Krishti dhe e rrëfeu me guxim. I burgosën së bashku, dhe gjatë natës, një engjëll u dha zemër për martirizimin.

Në mëngjes, Amfiloku urdhëroi t’i hidhnin në një kazan me vaj të përvëlur dhe rrëshirë të shkrirë; por, kur lënda preku trupat e shenjtorëve, menjëherë ngriu.

Para kësaj mrekullie besoi edhe vetë Amfiloku dhe thirri: “O Zoti Jisu Krisht, eja më ndihmo!”. Atëherë një zë hyjnor iu përgjigj: “Lutja jote u dëgjua, eja, ngjitu deri tek unë!”.

Kur mësoi këto ngjarje, Adriani vendosi të shkonte vetë atje. Me të mbërritur, i mbushur me tërbim i hodhi të gjashtë martirët në një kazan, që e lanë të vlonte për shtatë ditë. Por shenjtorët dolën të pacenuar prej tij dhe perandori u detyrua të kthehej në Romë i turpëruar dhe i pafuqishëm.

SHĒN
MATRONA E SELANIKUT

SHĒN
LIDIA



— [facebook.com/koash1991](https://www.facebook.com/koash1991)